



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**MINISTRIA E ARSIMIT,  
SPORTIT DHE RINISË**

**MINISTRIA E SHTETIT PËR DIASPORËN**

Nr.10700 Prot. Tiranë, më 15.10.2018

Nr.4791 Prot. Tiranë, më 16.10.2018

NR.682, DATË 15.10.2018

**PËR REGJISTRIN SHTETËROR TË MËSUESVE TË  
DIASPORËS DHE TË CERTIFIKATËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 12, pika 5 të ligjit nr.48/2018, datë 02.08.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar",

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektakteve nënligjore për regjistrin shtetëror të mësuesve të diasporës dhe të certifikatës së nxënësve në diasporë, me përbërjen e mëposhtme:

a. Besnik Rama	Kryetar, MASR
b. Anila Ferizaj	Anëtar, MASR
c. Dorina Rapti	Anëtar, IZHA
d. Ilda Sadikaj	Anëtar, MASR
e. Altea Tahiraj	Anëtar, MASR
f. Florian Nurçe	Anëtar, MASR
g. Dritan Delija	Anëtar, MSHD
h. Erta Skora	Anëtar, MSHD



2. Grupi i punës ka për detyrë:

- a. Të hartojë kriteret për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.
- b. Të hartojë kriteret për pajisjen me certifikatë të nxënësve që ndjekin programin e mësimi të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.
- c. Të bashkëpunojë me Ministrin e Shtetit për Diasporën për hartimin e projektakteve përkatëse.
- d. Të koordinojë punën me Ministrinë e linjës për përfundimin e projektakteve.
- e. Të depozitojë projektaktet dhe raportin përkatës të ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë deri me datë 9.11.2018.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe grupi i punës.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Lindita Nikolla

MINISTËR

Pandeli Majko